



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I PERFORMANCËS SHËNDETIT PUBLIK DHE SËMUNDJEVE KRONIKE

Raport mbi Programin e Depistimit të Shëndetit dhe Kujdesit Dentar për fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç në shkolla

1. Përse zbatohet ky program:

Programi i ri i dentistrisë në shkolla, vjen si një nismë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim depistimin dhe trajtimin e hershëm të shëndetit dentar te fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç në shkolla. Ky shërbim do të ofrohet falas për fëmijët e shkollave. Programi do të ofrojë depistimin periodik, edukim shëndetësor për ruajtjen dhe kujdesin e dhëmbëve si dhe shërbime konkrete, si fluorizimi, pastrim i gurëzave si dhe trajtimet urgjente apo mjekimet e patologjive të indeve të buta.

2. Implementimi i programit dhe vënia në zbatim:

Tiranë, 22 Prill – Lançohet Programi i Depistimit të Shëndetit dhe Kujdesit Dentar për fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç në shkolla, i mundur falë investimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ngritjen e kabineteve të reja dentare.

Programi fillimisht është pilotuar në qytetin e Tiranës në 10 shkolla, ku janë instaluar kabinetet e reja dentare. Më shumë se 11 mijë nxënës në këto 10 shkolla të kryeqytetit do të jenë përfituesit e parë të këtij shërbimi, për t'u shtrirë më pas në gjithë vendin.

Shkollat e pajisura me këto kabinate bashkëkohore do të ofrojnë shërbim edhe për fëmijët e shkollave të tjera që janë në të njëjtën zonë apo në zona të afërta sipas një grafiku me ditë të caktuara javore.

3. Dokumentimi dhe analizimi i të dhënave:

Gjatë testeve depistuese në shkolla, personeli shëndetësor që do të zhvillojë këtë proces do të dokumentojë zhvillimin e testit të depistimit.

Dokumentimi i këtij procesi bëhet nëpërmejt një skede të ndërtuar me të dhënat individuale të nxënësit sipas një formati të caktuar dhe ruhet në NJVKSH-në përkatëse.

4. Raportimi i të dhënave dhe analizimi i tyre:

Mbledhja e të dhënave nga NJVKSH-të në shkollat përkatëse, raportohen në Operatorin Rajonal Shëndetësor. 4 Operatorët Rajonalë (Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër) raportojnë pranë Drejtorisë Qëndrore të Ofrimit të Shërbimit dhe Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH) nëpërmjet e-mailit çdo dite të hëne.

5. Rezultate të programit të depistimit:

***Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë** – 10 kabinete të reja dentare, konkretisht shkollat 9 vjeçare “Halit Coka”, “Qazim Turdiu”, “Jeronim De Rada”, “Lasgush Poradeci”, “28 Nëntori”, “Mihal Grameno”, “Bajram Curri”, “Shkolla e Kuqe”, “Vasil Shanto”, “Kushtrimi i Lirisë”.

Aktiviteti i kryer në këto shkolla gjatë periudhës Shtator-Nëntor 2022, i raportuar në mënyrë progresive:

Vizita gjithsej:	3721
Depistime:	1889
Vizita në kabinet:	655
Mjekime:	311
Fluorizime:	686
Silanime:	148
Takime Edukuese/ Promocionale:	415

***Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës** - 3 kabinete të reja dentare janë vendosur në shkollat 9 vjeçare “Abedin Dino”, “Njazi Mastori” si dhe “Naim Babamenta”.

Aktiviteti i kryer në këto shkolla gjatë periudhës Shtator-Nëntor 2022, i raportuar në mënyrë progresive:

Vizita gjithsej:	656
Depistime:	301
Vizita në kabinet:	306
Mjekime:	44
Fluorizime:	0
Silanime:	0
Takime Edukuese/ Promocionale:	66.

***Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Elbasan** - 3 kabinete të reja dentare janë vendosur në shkollat 9 vjeçare “Luigi Gurakuqi”, Shkollën “Jorgji Dilo” si dhe shkollën “Bardhyl Popa”.

Aktiviteti i kryer në këto shkolla gjatë periudhës Shtator-Nëntor 2022, i raportuar në mënyrë progresive:

Vizita gjithsej:	329
Depistime:	230

Vizita në kabinet: 31

Mjekime: 8

Fluorizime: 2

Silanime: 27

***Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër** - 2 kabinete të reja dentare janë vendosur në shkollat 9 vjeçare “Ismail Qemali” dhe “Ndre Mjeda”.

**Të dhënat e mësipërme janë ofruar nga DROSHKSH në formatin word, jo në database, janë të dhëna vetëm për periudhën Shtator- Nëntor 2022.*

Bazuar në dokumentin strategjik “Programi Dentar” të ofruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale, Detyra e Institutit të Shëndetit Publik si institucion është i përcaktuar në “Parandalim: Ndërhyrjen në popullatë”specifikisht në përgatitjen e materialeve dhe organizimin e trajnimeve sistematike një ditore mbi këshillimin e kujdesit dentar për mësuesit dhe mjekët e shkollave me qëllim krijimin e Trainer of Trainers.

Gjithashtu është përcaktuar edhe detyra e Institutit të Shëndetit Publik si partner bashkëpunues së bashku me institucione të tjera në “Parandalim: Aplikimin e masave rregullatore” specifikisht në : Uljen e barrierave të njohura midis fëmijëve të vegjël dhe shërbimeve të shëndetit oral, rregullimin e shitjes së produkteve ushqimore në mjedise shkollore dhe promovimin e ushqyerjes së shëndetshme në mjediset shkollore .